

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Ap-Kz nr. 20/2012
4 shtator 2012

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Horst Proetel si kryetar i kolegjit, gjyqtareve të Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Marije Ademi, dhe gjyqtarëve të EULEX-it Martti Harsia dhe Gerrit-Marc Sprenger si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore Chiara Rojek si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër

F. K., emri i babait _____, mbiemri i vajzërisë i së ëmës _____, i lindur më _____ në fshatin _____, Komuna _____, ku edhe jeton tani, shtetas i Kosovës, i

I akuzuar sipas aktakuzës PPS nr.75/2010 të ngritur nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) më 30 mars 2011 dhe pjesërisht të konfirmuar më 29 prill 2011 me Aktvendimin KA nr. 76/2011, për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), e dënueshme edhe sipas neneve 23 dhe 121 paragrafit 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në lidhje me nenin 3 i përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 (katër Konventat e Gjenevës) dhe nenit 13 paragrafit 2 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, si dhe Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli shtesë II).

I shpallur fajtor në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 134/11 të Gjykatës së Qarkut në Prizren të datës 2 gusht 2011, për veprën penale Krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ-së, e dënueshme edhe sipas neneve 23 dhe 121 paragrafit 1 të KPK-së në lidhje me nenin 3 të përbashkët me katër Konventat e Gjenevës dhe nenin 13 paragrafit 2 të Protokollit II dhe i dënuar me pesë (5) vjet burgim.


Dhe **N. H.**, emri i babait _____, emri i së ëmës _____, i lindur më _____ në fshatin _____, Komuna _____, ku edhe jeton tani, shtetas i Kosovës,

I akuzuar sipas aktakuzës së _____ për veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale në kundërshtim të nenit 305 paragrafit 2 të KPK-së,

I shpallur fajtorë në shkallën e parë me aktgjykimin e njëjtë për veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale në kundërshtim të nenit 305 paragrafit 2 të KPK-së dhe i dënuar me dënim me kusht prej gjashtë (6) muajve burgim, Dhe të tjerëve,

Duke vepruar lidhur me ankesat e ushtruara nga avokati mbrojtës Ethem Rugova në emër të të pandehurit **F. K.** më 8 nëntor 2011, dhe nga avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi në emër të të pandehurit **N. H.** më 3 nëntor 2011 kundër aktgjykimit P nr. 134/11 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 2 gusht 2011, dhe duke marrë parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) të paraqitur më 28 mars 2012,

Pas seancës publike të mbajtur më 4 shtator 2012 në praninë e të pandehurit **F. K.** avokatit të tij mbrojtës Ethem Rugova, të pandehurit **N. H.** prokurores Judit Tatrai për ZPShK-në, dhe avokatit Rastko Brajkovic si përfaqësues i palëve të dëmtuara, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur po këtë ditë,



Në përputhje me nenet 419 dhe tutje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë

AKTVENDIM

1. Ankesat e ushtruara nga avokati mbrojtës Ethem Rugova në emër të të pandehurit Ej K. dhe nga avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi në emër të të pandehurit N. H. kundër aktgjykimit P nr. 134/11 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 2 gusht 2011 PRANOHEN në përputhje me nenin 420 paragrafin 1, nën-paragrafin 3 dhe nenin 424 paragrafin 1 të KPPK-së.
2. Aktgjykimi P nr. 134/11 i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i datës 2 gusht 2011 ANULOHET, përveç pjesës që lidhet me shfajësimin e Haxhi Mazrekut që nuk i nënshtrohet kësaj procedure ankimore.
3. Lënda kundër të pandehurve E. K., N. H., M. H., M. H., N. H., B. H. dhe J. H. kthehet në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim, në përputhje me nenin 419, 420 paragrafin 1, nën-paragrafin 3 dhe nenin 424 paragrafin 1 të KPPK-së.

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës së lëndës


Më 30 mars 2011, PSRK-ja ngriti aktakuzën HEP nr. 185/2010 - PPS nr. 75/2010 që i akuzon Ej K. dhe H. M. për veprat penale Krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ-së, e dënueshme edhe sipas neneve 23 dhe 121 paragrafit 1 të KPK-së në lidhje me nenin 3 të përbashkët me katër Konventat e Gjenevës dhe nenin 13 paragrafit 2 të Protokollit II të Konventave (dy pika). Pesë të pandehurit e tjerë, M. H., N. H., N. H., B. H. dhe J. H. u akuzuan për veprën penale Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale në kundërshtim të nenit 305 paragrafit 2 të KPK-së.

Më 29 prill 2011, kjo aktakuzë u konfirmua pjesërisht me aktvendimin KA nr. 76/2011. Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës hodhi poshtë akuzën e dytë për krime të luftës kundër popullatës civile kundër E. K. dhe H. M.

Shqyrtimi gjuhësor u mbajt në qershor, korrik dhe gusht 2011. Më 2 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren lëshoi aktgjykimin P. Nr. 134/11 me të cilin E. K. u shpall fajtor për Krime të luftës kundër popullatës civile në bashkëkryerje, në kundërshtim të neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ-së, e dënueshme edhe sipas neneve 23 dhe 121 paragrafit 1 të KPK-së në lidhje me nenin 3 të përbashkët me katër Konventat e Gjenevës dhe nenin 13 paragrafit 2 të Protokollit II, "sepse në natën e 17 dhe mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998, si anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe në bashkëkryerje me ushtarë të tjerë të UÇK-së deri tani të paidentifikuar, aplikuan masa të frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile Serbe të Oplotushës duke marrë pjesë në sulm të qëllimshëm të armatosur kundër familjeve serbe në fshatin e përmendur." Ai u dënua me pesë (5) vjet burgim.

H. M. u lirua nga akuza në përputhje me nenin 390 pika 3 e KPPK-së.

N. H. dhe katër të pandehurit e tjerë u shpallën fajtorë për Dhënie të ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale në kundërshtim të nenit 305 paragrafit 2 të KPK-së, dhe u dënuan me gjashtë (6) muaj burgim me kusht, pasi që Gjykata e Qarkut konsideroi se i kanë dhënë ndihmë E. K. nën hetime duke dhënë dëshmi të rrejshme të dëshmitarëve në



mbështetje të alibisë së E. K., më saktësisht kur u dëgjuan në cilësinë e dëshmitarit nga policët e EULEX-it nga Njësi i Hetimeve të Krimeve të Luftës.¹ Prokurori special, avokati mbrojtës Ethem Rugova për E. K. dhe avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi për N. F. ushtruan ankesë kundër aktgjyqimit të shkallës së parë. Më 23 gusht 2012, kolegji i Gjykatës Supreme me aktvendimin Ap - Kz nr. 20/2012 hodhi poshtë ankesën e prokurorit special si të palejueshme.

II. Parashtrësas e palëve

A. Ankesa e prokurorit të PSRK-së

Prokurori special mbështet ankesën e tij në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike përkitazi me H. M. dhe e kundërshton vendimin mbi sanksionet penale të shqiptuara ndaj M. H., M. H., N. F., N. B. dhe J. K.

B. Ankesa e avokatit mbrojtës Ethem Rugova për të pandehurin F. K.

Avokati mbrojtës Ethem Rugova e mbështet ankesën e tij në bazë të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 402 paragrafi 1 pika 1 lidhur me nenin 403 paragrafin 3, 8 dhe 12 të KPPK-së, shkeljes së ligjit penal nga neni 402 paragrafi 1 pika 2 lidhur me nenin 404 pikën 1 dhe 4 të Kodit, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 402 paragrafi 1 pika 3 e Kodit, dhe në bazë të vendimit mbi sanksionet penale nga neni 402 paragrafi 1 pika 4 lidhur me nenin 406 paragrafin 1 të Kodit.

Mbrojtja pretendon se prokurori veproi në kundërshtim me nenet 221 dhe 222 të KPPK-së, pasi që aktvendimi mbi nisjen e hetimit ishte nxjerrë nga prokurori i PSRK-së kundër S. M., që më pastaj ishte zgjeruar kundër J. K., ndonëse prokurori nuk vazhdoi me hetimin kundër të dyshuarit N.

Mbrojtja i referohet procedurës penale kundër S. M. përpara Gjykatës së Qarkut në Beograd dhe Gjykatës Supreme të Serbisë në lëndën për Krime të luftës lidhur me ngjarjet në Opterushë në korrik 1998, si dhe 'gjyqimit të trilluar në Pozharevc të Serbisë. Avokati mbrojtës pretendon se të drejtat e mbrojtjes për propozimin e dëshmitarëve ishte penguar pasi që këta dëshmitarë do të rrezikonin të akuzoheshin nga prokurori special nëse do të ishin ftuar. Ai po ashtu kundërshton pse gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur lidhur me propozimin e mbrojtjes për papranueshmërinë e provave. Avokati mbrojtës pretendon se Gjykata e Qarkut nuk ka marrë parasysh propozimin e tij për përjashtimin e prokurorit special Maurizio Salustro.

Për më shumë, pohohet se të pandehurit e tjerë nuk kishin ndihmën e avokatit mbrojtës, edhe pse kjo është lëndë me mbrojtje të detyrueshme nga neni 73 i KPPK-së, dhe se gjykimi ishte mbajtur në mungesë të të pandehurve. Gjykata e shkallës së parë, rrjedhimisht, veproi në kundërshtim me nenin 403 paragrafin 1 pikën 3 të KPPK-së, lidhur me nenet 341 dhe 342 të Kodit.

Mbrojtja pretendon në shkelje të nenit 403 paragrafi 1 pikës 12 të KPPK-së sepse dispozitivi është i pakuptueshëm, i mungon saktësia dhe përmban kundërthënie më mes përmbajtjes së vet dhe arsyetimit të aktgjyqimit.

¹ Kolegji i Gjykatës së Qarkut urdhëroi lirimin e E. K. nga paraburgimi. Përveç kësaj, secili i person dënuar do t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në përputhje me nenin 102 paragrafin 1 të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të përkrahimit dhe interpretimit. E. K. do t'i mbulojë shpenzimet shtesë të kapjes dhe përcjelljes. Paditë pronësore do të trajtohen në çështje të veçantë civile.

Mbrojtja kundërshton vërtetimin e gjendjes faktike pasi që Kolegji i Gjykatës së Qarkut ka penguar verifikimin e disa rrethanave, p.sh. se E. K. ishte i pranishëm në fshat në kohën përkatëse dhe se nuk kishte njohuri për sulmin.

Mbrojtja pretendon në shkelje të nenit 406 paragrafit 1 të KPPK-së pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në vijim: ai është njeri familjar me gjendje të dobët ekonomike; është sjellë drejt gjatë hetimit dhe është paraqitur në gjykatë vullnetarisht. Prandaj, propozohet një dënim më i butë.

C. Ankesa e avokatit mbrojtës Hajrip Krasniqi për të pandehurin N H

Mbrojtja pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal, dhe kundërshton vendimin mbi sanksionet penale. Ai kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar, duke kërkuar lirimin e N. H. në përputhje me nenin 390 pikën 3 të KPPK-së, ose ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

Mbrojtja pretendon se vepra e kryer nga i pandehuri nuk është vepër penale përveç kur aktgjykimin i formës së prerë është lëshuar në lidhje me E. K.

Sipas mendimit të mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së, duke marrë parasysh se dispozitivi është i paqartë dhe i pakuptueshëm, dhe se aktgjykimin i kundërshtuar përmban mospërputhje në mes arsyetimit dhe përmbajtjes së procesverbalit përkitazi me dëshmitë e dhëna gjatë fazës së hetimeve, dhe atyre të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor.


Mbrojtja parashtron se, shkelja e ligjit penal ka ndodhur si rezultat i shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe vendimi mbi sanksionet penale ishte i paligjshëm.

D. Përgjigja ndaj ankesave të ushtruara nga avokati mbrojtës Osman Zajmi për H M

Avokati Osman Zajmi për H M i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të hedhë poshtë ankesën e prokurorit si të papranueshme në përputhje me nenin 422 të KPPK-së.

E. Mendimi dhe propozimi i Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)

Në mendimin dhe propozimin e saj, prokurorja e shtetit i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës: të vlerësojë nëse gjykata e shkallës së parë ka përmbushur obligime të saj që dalin nga parimet e prezumimit të pafajësisë, *in dubio pro reo* si dhe *favor rei*, se a janë vërtetuar faktet dhe përgjegjësia penale e E. K. përtej dyshimit të arsyeshëm; ta refuzojë ankesën e ushtruar në emër të N. H. si të pabazuar; ta hedhë poshtë ankesën e prokurorit të PSRK-së si të palejueshme; ta ndryshojë pjesën dënuuese të aktgjykimin sa i përket M. H., N. H. dhe J. K. duke përjashtuar afërsinë/të qenit pjesë e VCK-së dhe të meritë parasysh miqësinë/respektin për Ejup Kabashin si motiv për shqiptimin e sanksioneve të tilla për personat e dënuar, dhe të vërtetohet aktgjykimin i kundërshtuar në pjesët e mbetura të saj.



përgjegjës. Përfundimisht, Prokurori i shtetit çuditet me vlerën provuese të vetëm një prove p.sh. deklaratës së E B , për të dënuar E K

Mendimi dhe Propozimi i ZPSHK-së ndaj ankesës së paraqitur në emër të Naser Hotit

Pohohet se avokati mbrojtës ka gabuar nocionin e “kryerësit” me atë të “personit të dënuar” dhe se lirimi i mundshëm i E K nuk do të ndikonte në përgjegjësinë penale të pesë të pandehurve të tjerë të akuzuar për Dhënie e ndihmës. Qëllimi i nenit 305 paragrafit 2 është dënimi i atyre të cilët qëllimisht pengojnë zhvillimin e drejtësisë duke iu Dhënë ndihmë personave përgjegjësia penale e të cilëve është nën shqyrtim. Në këtë lëndë, Naser Hoti dhe të pandehurit e tjerë të cilët kanë qenë ose është dashur të jenë në dituri për angazhimin formal të UÇK-së që t’i përmbahen atyre normave dhe parimeve, kanë ndihmuar E K duke dhënë deklaratë të rrejshme në mbështetje të alibisë së të dyshuarit.

Përfundimisht, Prokurori i shtetit pohon se motivi i të pandehurve M H , M H , N H , N B dhe J K nuk është dashur të kenë ndikim në llogaritjen e dënimit sa i përket shqiptimit të një dënimi më të vogël. Prokurori i shtetit propozon ndryshimin e pjesës së dënimit në aktgjykim në mënyrë që të përjashtohen referencat në këto motive.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme gjen se ankesat e paraqitur në emër të dy të pandehurve janë të pranueshme sipas nenit 398 paragrafit 1 të KPPK-së.

Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se ankesat janë të bazuara sipas neneve 420 paragrafit 1, nën-paragrafit 3 dhe 424 paragrafit 1 të KPPK-së.

A. Kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës ka kompetenca që të vendosë mbi ankesat sipas neneve 26 paragrafit 1 dhe 398 dhe më tutje të KPPK-së.

Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me nenin 3 paragrafin 7 të Ligjit nr. 03/L-53 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Seanca publike është mbajtur më 4 shtator 2012.

B. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i shkallës së parë është shpallur më 2 gusht 2011.

Avokati mbrojtës Ethem Rugova dhe i pandehuri E K e kanë marrë aktgjykimin e kundërshtuar më 26 tetor. Ankesa e avokatit mbrojtës është regjistruar në gjykatë më 8 nëntor. Avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi ka paraqitur ankesë për të pandehurin N H më 3 nëntor 2011. Avokati mbrojtës e ka marrë aktgjykimin më 25 tetor dhe N H nuk e ka përmendur asnjë datë të pranimit në fletë-dërgesë. Gjykata Supreme konsideron ankesat si të paraqitura me kohë dhe nga personi i autorizuar, dhe prandaj të pranueshme sipas nenit 398 paragrafit 1 të KPPK-së.

C. Meritat e ankesave

Që gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 3 të KPPK-së

Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se ky pretendim është pa merita. Në lidhje me këtë mbrojtja ka ngritur dy argumente: disa të pandehur nuk kanë pasur ndihmën e avokatit mbrojtës gjatë seancave të gjyqimit; dhe gjykimi është mbajtur në mungesë të disa të pandehurve.

Sa i përket pjesës së parë të pretendimit, Gjykata Supreme plotësisht pajtohet me mendimin e Prokurorit të shtetit se kjo bazë është e aplikueshme në mënyrë specifike për disa të pandehur përveç E. K. Përveç kësaj, M. H. dhe të pandehurit e tjerë janë akuzuar për veprën penale Dhënie e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale për të cilën parashihet dënimi me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vite. Katër raste të mbrojtjes së domosdoshme parashihen në nenin 73 paragrafin 1 të KPPK-së. Asnjëri nga kushtet e mbrojtjes së domosdoshme nuk është plotësuar në këtë rast, posaçërisht duke pasur parasysh se asnjëri nga të pandehurit nuk është akuzuar për vepër penale të "dënueshme me së paku tetë vite me burgim" siç është përcaktuar me nenin 73 paragrafin 1 pikën 3 të KPPK-së. Gjithashtu nga procesverbali i gjyqimit del se të pandehurit nuk kanë kundërshtuar mungesën e avokatit mbrojtës për t'i përfaqësuar ata.⁵ Prandaj, ky pretendim është i pabazuar.

Në lidhje me pretendimin e dytë nën këtë bazë, vërehet se njëri nga të pandehurit N. H., ka munguar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 27 korrik 2011. Kjo është në kundërshtim të parimit fundamental të përcaktuar në KPPK-ë sipas të cilit prania e të pandehurit gjatë gjyqimit është e natyrës së detyrueshme sipas ligjit të procedurës.⁶ Sipas jurisprudencës së GjEDNJ, e drejta për të marrë pjesë efektive në shqyrtim është absolutisht e garantuar sipas nenit 6 paragrafëve 1 dhe 3 c), d) dhe e) të KEDNJ-së.⁷ Përjashtimet ndaj këtij parimi të përgjithshëm mund të gjendet në tërë KPPK-në p.sh. shpallja e aktgjyqimit në mungesë të palës sipas nenit 392 paragrafit 3 të KPPK-së. GjEDNJ pohon se gjykimi *in absentia* nuk është në kundërshtim *per se* me standardet e gjyqimit të drejtë, sidoqoftë procedura e tillë duhet të jetë në përputhje me minimumin e standardeve procedurale. Sipas mendimit të GjEDNJ-së, i akuzuari mund të heq dorë nga e drejta që të jetë i pranishëm gjatë shqyrtimit në mënyrë pa-ekuivokë.⁸

Në këtë lëndë, N. H. ka kërkuar nga trupi gjykues më 26 korrik 2011 që mos të marrë pjesë në shqyrtimin e caktuar për ditën e ardhshme. Kolegji i ka dhënë mundësinë të pandehurit që ta jap fjalën e tij përfundimtare. Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut pastaj është

⁵ Shih *inter alla* për të pandehurin N. H. Gjykata e Qarkut në Prizren, P nr. 134/2011, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 29 qershor 2011, faqe 2; procesverbali i 30 qershorit 2011, faqe 2; procesverbali i 7 korrikut 2011, faqe 2

⁶ Shih *inter alla* nenin 321 paragrafin 1, nenin 330 paragrafin 1, nenin 403 paragrafin 1 pikën 3 të KPPK-së

⁷ Shih GjEDNJ, Colozza kundër Italisë, kërkesa nr. 9024/80, Aktgjykimi, 12 shkurt 1985, para 27: "27. Edhe pse nuk është përmendur shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 6 (art. 6-1), objekti dhe qëllimi i nenit marrë në tërësi tregon se personi "i akuzuar për një vepër penale" ka të drejtë të marrë pjesë në shqyrtim. Për më tepër, nën-paragrafët (c), (d) dhe (e) të paragrafit 3 (neni 6-3-c, neni 6-3-d, neni 6-3-e) i garanton të "gjithë të akuzuarve për vepra penale" të drejtën "të personalisht ta mbrojnë vetën", të ekzaminojnë dëshmitarë" dhe "të kanë ndihmën e përkthyesit pa pagesë nëse nuk e kupton apo flet gjuhën e përdorur nga gjykata", dhe është vështirë të shihet se si ai mund t'i ushtroj këto të drejta paqenë i pranishëm."

⁸ GjEDNJ, Poitrimol kundër Francës, kërkesa nr. 14032/88, Aktgjykimi, 23 nëntor 1993, para 31: "31. Procedura e mbajtur në mungesë të akuzuarit në prani, nuk është në mospërputhje me Konventën nëse personi në fjalë më pas mund të marrë nga gjykata e cila e ka dëgjuar atë një përcaktim të ri të meritave të akuzës, në lidhje me ligjin dhe faktet (shih, mutatis mutandis, aktgjykimi Colozza paraprakisht i cituar, Seria A nr. 89, f. 14, para. 27, dhe f. 15, para. 29). Është i hapur ndaj pyetjes nëse Kushti i fundit vlen kur i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta të paraqitet dhe ta mbrojë vetën, por në të gjitha rastet heqja dorë e tillë duhet patjetër, nëse do të jetë efektive për qëllime të Konventës, të vërtetohet në mënyrë pa-ekuivokë dhe të jetë e shoqëruar me minimumin e mbrojtjes në proporcion me rëndësinë e saj (shih Pfeiffer dhe Plankl kundër Austrisë aktgjykimi 25 shkurt 1992, Seria A nr. 227, pp. 16-17 para. 37)."

këshilluar lidhur me këtë çështje. Pasi që është pyetur nga kryetari i trupit gjykues, "ju jeni në dijeni se edhe pse keni të drejtë ju nuk do ta jepni fjalën përfundimtare nesër dhe se tërësisht do të përfaqësoheni nga avokati jonë", i pandehuri ka konfirmuar se është në dijeni. Më 27 korrik, N. H. të cilit i është dhënë 'leje' për mospjesëmarrje në seancë është përfaqësuar nga avokati i tij mbrojtës.⁹

Duke vendosur në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë në të vërtetë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 3 të KPPK-së. Megjithatë, kolegji i poshtë nënshkruar vëren se N. H. pa ekuivokë dhe në mënyrë vullnetare ka hequr dorë nga pjesëmarrja në seancën gjyqësore dhe ka pasur ndihmën e avokatit të tij mbrojtës gjatë mungesës së tij. Atij i është dhënë mundësia që ta dorëzojë fjalën përfundimtare. Si rrjedhojë, të drejtat në mbrojtje të të pandehurit H. janë respektuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kjo gjithashtu është theksuar me faktin se avokati Hajrip Krasniqi nuk ka paraqitur asnjë pretendim lidhur me këtë pikë në ankesën e tij. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, shkelja procedurale e cila i atribuohet një të pandehuri për shkak të veprimit të tij nuk mund ta zhvleftësojë tërë procedurën penale në këtë lëndë, posaçërisht në lidhje me të pandehurin tjetër E. K. Prandaj, kolegji i Gjykatës Supreme duke e konsideruar këtë pretendim të bazuar, mendon se shkelja e tillë nuk e arsyeton anulimin e aktgjyqimit të kundërshtuar dhe kthimin e lëndës në shkallën e parë.


Që gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 të KPPK-së

Kolegji i Gjykatës Supreme pajtohet me parashtrirat e mbrojtjes se dispozitivi i aktgjyqimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm në lidhje me veprën e kryer nga i pandehuri E. K. dhe cilësimin juridik të kësaj vepre.

Së pari, në lidhje me vetë veprën, E. K. është dënuar për kryerjen e veprës penale Aplikimi i masave të frikësimit dhe terrorit sipas nenit 142 të KPRSFJ-së "sepse në natën e 17 dhe në mëngjesin e hershëm të 18 korrikut 1998, në cilësinë e tij si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), dhe në bashkëkryerje me të ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të pidentifikuar, ka aplikuar masa të frikësimit dhe terrorit kundër popullatës civile Serbe të Oplotushës duke marrë pjesë në sulm të armatosur të qëllimshëm kundër shtëpive Serbe në fshatin në fjalë". Kolegji i Gjykatës Supreme vëren se madje edhe me leximin e fakteve përshkruese të përmbajtura në dispozitiv të bashku me arsyetimin e aktgjyqimit të kontestuar (faqet 8-32), nuk e bën dispozitivin të qartë dhe të kuptueshëm. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, vetëm referimi në "pjesëmarrjen në sulm të armatosur kundër shtëpive Serbe në fshatin në fjalë" nuk ofron në mënyrë të mjaftueshme një deklaram të qartë të fakteve dhe rrethanave të cilat tregojnë veprën e kryer nga i pandehuri.

Përveç kësaj, sipas dispozitivit të aktgjyqimit të kundërshtuar, i pandehuri E. K. është shpallur fajtor për Krime lufte kundër popullatës civile në bashkëkryerje "sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ-së), e dënueshme edhe me nenet 23 dhe 121 (1) të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në lidhje me nenin 3 i përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12.08.1949 dhe nenin 13.2 të Protokollit të II të 08.06.1977, plotësuës i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (Protokolli shtesë)". Gjatë leximit të dispozitave të KPK-së duket se neni 121 paragrafi 1 i Kodit

⁹ Shih Gjykata e Qarkut në Prizren, P nr. 134/2011, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 26 korrik 2011 faqe 15; procesverbali 27 korrik 2011, faqe 2.



përmban vetëm një dispozitë të përgjithshme e cila dënon kryerjen dhe përcakton shkallët e dënimit. Veprat të cilat përbëjnë “shkelje të rëndë të ligjeve dhe traditave të aplikueshme në konfliktet e karakterit jo ndërkombëtar” janë specifikuar nën paragrafin 2, nën 24 pika. Gjykata Supreme e Kosovës vëren se dispozitivi përmban dispozitat e sakta të ligjit të aplikueshëm në kohën e kryerjes p.sh. nenet e KP RSFJ-së. Sidoqoftë, në lidhje me ligjin e aplikueshëm aktual, vetëm neni 121 paragrafi 1 i KPK-së është përmendur. Kolegji i poshtë nënshkruar është i mendimit se referimi i qartë në përcaktimin juridik të dispozitës aktuale të aplikueshme duke dënuar sjelljen në fjalë është gjithashtu e rëndësishme vitale për leximin dhe kuptimin e dispozitivit. Në fakt, njëri prej këtyre elementeve të detyrueshëm të dispozitivit është “cilësimi juridik i veprave dhe ofrimi i ligjit penal të aplikuar në marrjen e aktgjykimit” sipas nenit 391 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë në këtë rast nuk i është përmbajtur kësaj dispozite.

Prandaj, Gjykata Supreme duke iu referuar jurisprudencës së saj të cituar nga Prokurori i shtetit,¹⁰ përfundon se është bërë shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 në lidhje me nenin 391 të KPPK-së nga gjykata e shkallës së parë duke çuar në anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e lëndës në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës Supreme nuk ka nevojë që të ekzaminoj bazat tjera të ankesës pasi që shkelja esenciale e ligjit të procedurës tanimë është vërtetuar. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, është vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit:

Gjyqtar i EULEX-it Horst Proetel

Anëtare e kolegjit:

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Emine Mustafa

Anëtare e kolegjit:

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Marije Ademi

Anëtar i kolegjit:


Gjyqtar i EULEX-it Martti Harsia

Anëtar i kolegjit:

Gjyqtar i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger

Procesmbajtëse:

Zyrtare ligjore Chiara Rojek



¹⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, Pkl-Kzz nr. 114/09, Leme Xhema, Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, 12 prill 2010, faqe 6: “f) në bazë të parimit të përgjithshëm se një veprë duhet të interpretohet në atë mënyrë që të ketë kuptim dhe jo në atë mënyrë që nuk ka kuptim, dispozitivi dhe arsyetimi duhet të lexohen së bashku (ligji përcakton se ato duhet të jenë në përputhje me njëra tjetrën);vetëm nëse dispozitivi mbetet i pakuptueshëm ose në mospërputhje pasi të jetë lexuar në lidhje me arsyetimin, mund të shpallet i kundërligjshëm.”